

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 1136 prot.,

Datë 17 . 03 .2022

VENDIM

Nr. 14, DATË 17.03.2022

PËR
SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË TABELAVE PËRMBLEDHËSE TË
MONITORIMIT TË MBULIMIT NGA OFRUESIT E SHËRBIMIT MEDIATIK
AUDIO/AUDIOVIZIV TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE PËR PERIUDHËN 19 SHKURT 2022 – 04
MARS 2022, SI DHE RESPEKTIMIN E PERIUDHËS SË HESHTJES ZGJEDHORE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA i përbërë nga:

Armela	Krasniqi	Kryetar
Aurela	Bicja	Anëtar
Besian	Zogaj	Anëtar
Desada	Metaj	Anëtar
Gjergji	Hamiti	Anëtar
Jetmir	Halilaj	Anëtar
Joana	Allushi	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për periudhën 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022 si dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 77 - 84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive”,

VËREN SE:

Në zbatim të nenit 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA është ngarkuar me monitorimin e fushatës zgjedhore në mediat audiovizive.

Sipas kësaj dispozite ligjore:

1. Monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, AMA. Monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet.
2. Enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë e operatorëve radiotelevizivë monitoron zbatimin e rregullave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore me karakter normativ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ, nga operatorët radiotelevizivë dhe nga subjektet zgjedhore.
3. Jo më vonë se 3 muaj para datës së zgjedhjeve KQZ miraton dhe publikon Metodologjinë e Monitorimit të Medias.
4. Enti rregullator i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara, minimalisht të përjavshme, të cilat ia paraqet KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen, sipas rastit, me propozimet për masa administrative. Raportet e monitorimit të medias publikohen në faqen e internetit të KQZ-së menjëherë sapo depozitohen në KQZ. Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë të drejtë të depozitojnë komentet dhe propozimet e tyre para KQZ-së, të cilat shqyrtohen bashkë me raportin.
5. KQZ-ja urdhëron korrigjimin e sjelljes për operatorët radiotelevizivë ose subjektet zgjedhore, ose, sipas rastit, vendos sanksione administrative ndaj tyre, mbështetur në gjetjet e veta, në ato të raporteve të monitorimit, si dhe në informacionet, ankimet apo denoncimet e palëve të treta, të verifikuara prej saj. Vendimet e KQZ-së ankimohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të KQZ-së.

Komisioni Rregullator pranë KQZ-së, me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 ka miratuar Metodologjinë e Monitorimit të medias audio dhe audiovizive, akt në të cilin parashikohen procedurat dhe teknikat që duhet të ndjekë AMA gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore. Në nenet 9 dhe 10 të Metodologjisë përcaktohet përmbajtja e raporteve të monitorimit dhe paraqitja e tyre në KQZ. Në pikën 2 të nenit 10, po të këtij akti, parashikohet se *“AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasore dhe cilësore), minimalisht njëherë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë”*.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me shkresën nr. 464 prot., datë 02.02.2022, administruar në AMA me nr. 550 prot., datë 03.02.2022, ka depozituar kërkesë për monitorimin e fushatës elektorale për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 06 mars 2022.

Komisioni rregullator pranë KQZ-së me vendimin nr. 2, datë 22 janar 2022 ka miratuar disa afate proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, për zgjedhjet e datës 06 mars 2022. Sipas këtij akti *“Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 (tre) ditëve të fundit pra datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjes deri në orën e mbylljes së votimit.”*

KQZ me shkresën e mësipërme, njofton se AMA monitoron OSHMA për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike, nga data 31 janar 2022 - 06 mars 2022, nga ora 08:00-00:00. Në zbatim të sa më sipër, sa i përket aktiviteteve të ndaluara, AMA, monitoroi subjektet audiovizive duke nisur nga kontrolli disa herë në ditë i faqes zyrtare të internetit të KQZ-së, konkretisht në rubrikën “Aktivitete të ndaluara”.

Gjatë fushatës zgjedhore 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022, janë monitoruar përmbajtjet programore të 35 OSHMA-ve (kanaleve). Subjektet e përfshira në monitorim ushtrojnë

veprimtari audiovizive mbështetur në platformë tokësore, satelitore, kabllore, IPTV dhe internet TV.

Me qëllim përfshirjen e të gjithë subjekteve audiovizive të licencuar/autorizuar në zonat ku janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, subjektet audio me shtrirje kombëtare nuk janë përfshirë në monitorim, për mbulimin e kësaj fushate.

Subjektet e licencuar dhe autorizuar për të ofruar shërbim në zonat ku janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme si dhe subjektet që sipas licencës të tyre mbulojnë më shumë se 48% të popullsisë janë në total, 37 subjekte.

Më poshtë lista e subjekteve TV rajonale të përfshira në monitorim. (sipas tabelës më poshtë)

Nr	Kanali	Territori	Programacioni
1	RTSH 1	Kombëtar	Gjeneralist
2	RTSH 2	Kombëtar	Gjeneralist
3	RTSH 24	Kombëtar	Informativ
4	TV TOP CHANNEL	Kombëtar	Gjeneralist
5	TV KLAN	Kombëtar	Gjeneralist
6	TV VIZION PLUS	Kombëtar	Gjeneralist
7	KLAN NEWS	Kombëtar	Informativ
8	TOP NEWS	Kombëtar	Informativ
9	KLAN PLUS	Kombëtar	Gjeneralist
10	NEWS 24	Rajonal	Informativ
11	REPORT TV	Rajonal	Informativ
12	FAX NEWS	Rajonal	Informativ
13	SHIJAK TV	Rajonal	Gjeneralist
14	MCN TV	Rajonal	Gjeneralist
15	SYRI TV	Rajonal	informativ
16	SCAN HD	Rajonal	Gjeneralist
17	ABC	Rajonal	Gjeneralist
18	EURONEWS BALLKANS	Rajonal	Informativ
19	A2 CNN	Rajonal	Informativ
20	ORA NEWS	Rajonal	Informativ
21	RTV ORA	Rajonal	Gjeneralist
22	CLUB TV	Rajonal	Gjeneralist

Referuar listës së programeve, pjesë e paketës programore të OSHMA publike dhe private (kombëtare dhe lokale), janë të përfshirë në monitorim, programet me karakter gjeneralist dhe informativ.

Nga programet/kanalet e RTSH-së janë zgjedhur për monitorim çdo ditë:

- RTSH 1, që është kanali kryesor dhe që bart dukshëm linjën editoriale si në edicionet informative ashtu dhe në programet të ndryshme nga aktualiteti; RTSH 2, që jep edicione lajmesh dhe në gjuhën e pakicave; si dhe RTSH 24, duke qenë se transmeton 24/7 vetëm lajme.
- RTSH Shkodra, program publik rajonal ka rezultuar se është në statusin “prova teknike”

- Kanalet e tjera tematike nuk rezultojnë që të kenë edicione ose programe informative që lidhen me fushatën.

Nga programet/kanalet e OSHMA private, nuk janë të përfshirë në monitorim shërbimet programore/kanalet që kanë karakter tematik (fëmijë, shkencë, film etj) Kanalet tematike nuk rezultojnë që të kenë edicione ose programe informative që lidhen me fushatën.

OSHMA/kanalet licencuar për të ofruar shërbim në zonat ku janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme të datës 06 mars 2022, dhe që mbulojnë më pak se 48% të popullsisë janë:

Nr	Kanali	Territori	Programacioni
1	TV Rozafa Motiv	Rajonal (Shkodër dhe Lezhë)	Gjeneralist
2	TV Star Plus	Lokal (Shkodër)	Informativ
3	TV Channel 1	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
4	TV Kopliku	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
5	TV Antena Nord	Lokal (Shkodër)	Gjeneralist
6	TV BS	Lokal (Shkodër)	Muzikor
7	TV Apollon	Rajonal (Fier dhe Vlorë)	Gjeneralist
8	TV Mat	Lokal (Diber)	Gjeneralist
9	TV Jug	Lokal (Fier)	Gjeneralist

Nga këto 6 kanale me licencë lokale janë regjistruar nga studio e regjistrimit pranë AMA. (TV Rozafa, TV Star Plus, TV Channel 1, TV Kopliku, TV BS dhe TV Apollon). Ndërsa sa i përket kanaleve: "TV Antena Nord" ka ndërprerë transmetimet audiovizive që më datë 24.01.2022, "TV Jug" nuk ofron shërbim audioviziv. "TV BS" ofron vetëm përmbajtje muzikore. Subjekti "Panorama TV", nuk ofron përmbajtje audiovizive.

Një tjetër kategori subjektësh, OSHMA, janë edhe subjektet e pajisura me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor, internet, IPTV etj. Më poshtë lista e subjekteve OSHMA që ushtrojnë aktivitet në bashkitë ku janë zhvilluar zgjedhjet e pjesshme:

1. Zjarr TV - regjistrohet nga studio e monitorimit.
2. Adria Net - regjistrohet nga studio e monitorimit.
3. TV 4+ - regjistrohet nga studio e monitorimit.
4. TV Gold - regjistrohet nga studio e monitorimit dhe rezultoi se ky subjekt nuk transmeton përmbajtje të fushatës zgjedhore

Në zbatim të Metodologjisë së Monitorimit të cituar më lart, AMA ka përcjellë çdo ditë në KQZ, raportin ditor të monitorimit ku janë prezantuar problematikat e konstatuara në subjektet e monitoruara.

Në këtë raport përmbledhës, për periudhën 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022 paraqiten tregues të tabelizuar si dhe propozime përkatëse për marrjen e masave administrative. Ky raport përmbledhës përmban të dhëna mbi:

- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve gjatë gjithë fushatës zgjedhore, për transmetimet e lajmeve, hapësirën për çdo aktor politik;

- Kohën e monitorimit të OSHMA-ve, për transmetimet e emisioneve, gjatë gjithë fushatës zgjedhore;
- Reklamat politike, në periudhën 19 shkurt 2022 – 4 mars 2022;
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatik të kandidatëve;
- Publikimin e sondazheve zgjedhore jashtë kohës së lejuar;
- Respektimin e heshtjes zgjedhore.

I. Të dhënat mbi edicionet informative

Neni 81 i Kodit Zgjedhor parashikon se *në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizivë private.*

Në tabelën nr. 1, bashkëlidhur pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike në edicionet informative të OSHMA-ve të përfshira në monitorim, për periudhën 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022.

Nga shqyrtimi i të dhënave të tabelës rezulton se OSHMA-të e mëposhtme nuk kanë krijuar balancë mes dy partive kryesore PS dhe PD (me diferencë më shumë se 30 minuta):

- Klan News
- Klan Plus
- News 24
- Ora News
- ABC News
- Shijak TV
- A2/CNN
- Zjarr TV
- Adrianet
- Fax News
- Star Plus
- Rozafa TV

AMA vëren se OSHMA e mëposhtme nuk respektuan kërkesat e Kodit Zgjedhor mbi kohën e vendosur në dispozicion për partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend:

- Klan TV
 - Klan News
 - Klan Plus
 - Vizion Plus
 - Ora News
 - Syri TV
 - Shijak TV
-

- Star Plus
- TV 1 Channel

Propozim I:

AMA i propozon KQZ-së të tërheqë vëmendjen për OSHMA-të e mësipërme për mosrespektimin e kërkesave të nenit 81 të Kodit Zgjedhor.

II. Përmbledhja e të dhënave mbi emisionet

Në tabelën Nr. 2/1, "Emisionet", jepen të dhëna përmbledhëse për periudhën 19 shkurt 2022-04 mars 2022, mbi kohën që iu kanë dhënë OSHMA-të, subjekteve politike gjatë emisioneve dedikuar fushatës zgjedhore.

III. Të dhënat mbi reklamën politike

Neni 84 i Kodit Zgjedhor parashikon kushtet e transmetimit të reklamave politike. Në këtë dispozitë parashikohet se:

"4. ... Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porositës. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, KQZ-ja urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë.

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. ..."

7. Reklamën politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor."

Duke iu referuar të dhënave të tabelës përmbledhëse për reklamën politike, rezulton se disa OSHMA kanë kaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues (që është përcaktuar deri në 90 minuta). Konkretisht e kanë tejkaluar kohën e reklamave politike, OSHMA-të e mëposhtme:

Syri TV	113.58 minuta total (SHL)
Star Plus	148.48 minuta total (PS) dhe 115.95 minuta total (PD)
TV Kopliku	184.93 minuta total (PS)

Sa i përket orareve të transmetimit të reklamave politike, siç dhe kemi informuar përmes raporteve ditore të periudhës 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022, AMA ka konstatuar raste të transmetimit të reklamave politike jashtë fashës orare të lejuar nga Kodi Zgjedhor. Konkretisht:

OSHMA	Data
TV Kopliku	(25.02); (26.02); (27.02); (28.02); (01.03) dhe (02.03)

Star Plus	(01.03) dhe (02.03)
Apollon	(01.03) dhe (02.03)
RTSH 2	(01.03)
Syri TV	(02.03) dhe (03.03)
TV 1 Channel	(03.03) dhe (04.03)

Propozim III

AMA i propozon KQZ-së që t'i tërheqë vëmendjen OSHMA- së, mbi mosrespektimin e kërkesave të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, për transmetimin e reklamave politike.

IV. Respektimi i heshtjes zgjedhore

Neni 77 i Kodit Zgjedhor parashikon:

“2. Dita përpara datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit, formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore nëpërmjet organeve të medias, si dhe zhvillimi i mitingjeve ose i veprimtarive të tjera zgjedhore të subjekteve zgjedhore.”

Në datën 05.03.2021, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, janë identifikuar OSHMA, të cilat nuk kanë respektuar kërkesat e Kodit Zgjedhor. Konkretisht:

- RTSH 1 - ritransmetoi emisionin “Publikisht”, (13:40 – 15:14) dhe gjatë trajtimit të temës “Vendoret e 6 marsit” kishte përmbajtje nga fushata elektorale.
- KLAN NEWS- transmetoi disa herë një kronikë rreth 2 minuta, mbi një promovim nga Ministria e Shëndetësisë në Shkodër, e cila është një nga bashkitë ku zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore.
- SHIJAK TV – transmetoi në fashat orare 10:14 -10:20 dhe 12:09 - 12:14 kronika nga zhvillimi i fushatës zgjedhore.
- ADRIANET TV - transmetoi një kronikë 3 minuta në orën 08:02 nga zhvillimi i fushatës zgjedhore në bashkinë e Durrësit.
- TV 4+ - transmetoi në orën 08:59 një intervistë të përmbledhur me një nga kandidatët për kryetar bashkie në Lushnjë.
- TV ROZAFIA – transmetoi në orarin 12:03 një kronikë mbi promovimin e veprave të infrastrukturës në bashkinë e Shkodrës, si dhe një promovim nga Ministria e Shëndetësisë po në këtë qytet, ku zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore.
- ZJARR TV- transmetoi në fashën orare 16:06-16:21, tri kronika të ndryshme nga zhvillimet e fushatës zgjedhore.

Propozim IV

AMA vëren se përmbajtjet e transmetuara janë ritransmetime nga veprimtaritë politike të një dite më parë dhe i propozon KQZ-së marrjen e masave administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor

V. Publikimi i sondazheve zgjedhore

Neni 78 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

“... 4. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.
5. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit.”

Sikurse u citua më lart, Komisioni Rregullator pranë KQZ-së me vendimin nr. 2, datë 22 janar 2022 ka miratuar disa afate proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, për zgjedhjet e datës 06 mars 2022. Sipas këtij akti “Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 (tre) ditëve të fundit pra datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjes deri në orën e mbylljes së votimit.”

Nisur nga monitorimi i respektimit të kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor (publikimi i sondazheve zgjedhore), për periudhën 19 shkurt 2022 deri më 03 mars 2022 në sondazhet që janë pasqyruar në përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të janë identifikuar disa raste kur nuk janë respektuar plotësisht kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Rastet kur OSHMA-të nuk e dhanë të plotë informacionin identifikues të sondazhit

OSHMA	Data
EuroNews Albania	(19.02) dhe (21.02)
Top News	(21.02)
News 24	(02.03)

Rastet Kur OSHMA prezantuan sondazh jashtë afatit të lejuar

OSHMA	Data
Klan	(04.03)
Top News	(04.03)

Propozim V:

AMA i propozon KQZ-së që të tërheqë vëmendjen për OSHMA- të mbi mosrespektimin e gjithë kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor.

Bashkëlidhur, këtij vendimi gjenden tabelat përmbledhëse për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në periudhën 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022, të cilat janë të bazuara në raportimet ditore që AMA ka dorëzuar pranë KQZ-së dhe që janë publikuar periodikisht në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

Në pikën 2 të nenit 10 të metodologjisë së monitorimit të medias audio/udiovizive, parashikohet se: “AMA i pasqyron gjetjet e veta në raporte të detajuara (sasiorë dhe cilësorë), minimalisht një herë në javë, të cilat ia paraqet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë”,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në zbatim të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 77-84 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive",

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit, nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për periudhën 19 shkurt 2022 – 04 mars 2022.
2. T'i propozojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:
 - 2.1 Tërheqjen e vëmendjes ndaj OSHMA-ve që rezultojnë me disbalancë në edicionet informative.
 - 2.2 Tërheqjen e vëmendjes ndaj OSHMA-ve mbi mosrespektimin e kërkesave të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, për transmetimin e reklamave politike.
 - 2.3 Marrjen e masës administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor ndaj OSHMA-ve: "RTSH 1", "Klan News", "Shijak TV", "Adrianet TV", "TV 4+", "TV Rozafa" dhe "Zjarr TV", për thyerje të heshtjes zgjedhore.
 - 2.4 T'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve: "TV Klan", "Top News", "News 24" dhe "EuroNews Albania", për mosrespektimin e kërkesat e nenit 78 të Kodit Zgjedhor, për publikimin e rezultateve të sondazheve zgjedhore.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e vendimit të mësipërm, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Armela	KRASNIQI
Anëtarë:	Aurela	BICJA
	Besian	ZOGAJ
	Desada	METAJ
	Gjergji	HAMITI
	Jetmir	HALILAJ
	Joana	ALLUSHI